



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4926 prot.

Himarë, më 02.07.2025

VENDIM

NR 30 DATE 27.06.2025

**“MBI TRANSFERIMIN KAPITAL PA PAGESË TË ASETEVE ME OBJEKT
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM TË ZONAVE
TURISTIKE, DHËRMI, GJILEKË, KONDRAQ DHE PALASË , NË ADMINISTRIM
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 23, pikës 14, nenit 28, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, në ligjin nr 139/2015 “Për Vetëeverisjen Vendore”, ligjit 9936 datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemimin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit Nr 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 03.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik” i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, si dhe me propozim të drejtorisë së menaxhimit të aseteve buxhetit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë këshilli bashkiak Himarë më datë 27.06.2025 pasi shqyrtoi materialin e miratoi me katërmëdhjetë (14) vota pro , tre (3) kundër , zero (0) abstenim dhe si më poshtë ,

V E N D O S I ;

1. Të miratohet transferimi kapital pa pagesë të aseteve me objekt “Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të zonave turistike, dhërmi, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë në administrim Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Vlorë SH.A
2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë SH.A, ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
3. Drejtoria e menaxhimit të aseteve, ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas legjislacionit në fuqi

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

